



MBI AKTIVITETIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR DHE ZHVILLIMET NË REFORMËN PËR MIRËQEVERISJEN, ANTIKORRUPSIONIN DHE SUNDIMIN E LIGJIT

**KPP – Buletin periodik 11
Maj-qershor 2025**



**KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR
“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN
PËR SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**

Maj-qershor 2025

Pas një procesi të gjerë konsultimi, gjatë muajit maj dhe qershor u punua për finalizimin e Planit Kombëtar të Veprimit, një produkt i Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë. Nga konsultimi i këtij dokumenti pati rreth 160 komente nga institucionet publike, grupet e interesit, shoqëria civile, bota akademike, përfshirë edhe vlerësimet dhe komentet e ekspertëve vendas e ndërkombëtarë si dhe të grupit të negociatorëve të angazhuar me procesin e negociatave me BE-në etj.

Hartimi i Planit Kombëtar të Veprimit, përmbyllen dy fazat e para të punës së Komisionit të Posaçëm

Pas Dokumentit Analitik dhe finalizimit të Planit Kombëtar të Veprimit, përmbyllen dy fazat e para të punës së Komisionit të Posaçëm për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit. Plani Kombëtar i Veprimit do të shërbejë para së gjithash për fuqizimin e kontributit dhe rolit aktiv të Kuvendit në forcimin e mirëqeverisjes, antikorrupsionit dhe sundimin e ligjit në përputhje me përcaktimet e bëra në rezolutën e Kuvendit si dhe në procesin e negociatave. Dokumenti përcakton masa konkrete për forcimin e kapaciteteve institucionale, përmirësimin e procesit të ligjvënies dhe monitorimin efektiv të procesit të integritetit.

Plani Kombëtar i Veprimit është një dokument që përcakton masa konkrete, të cilat synojnë përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësisë të Kuvendit në procesin e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian, me fokus kryesor thellimin e reformave në luftën kundër korrupsionit për qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit. Plani Kombëtar i Veprimit përmban 56 fusha tematike, të cilat trajtojnë çështjet kryesore me 245 masa konkrete, nga të cilat 71 janë nisma ligjore dhe 174 masa institucionale. Të ndara sipas tri shtyllave kryesore, masat shpërndahen si më poshtë:

1. Mirëqeverisja: 25 fusha tematike; 68 masa (16 nisma ligjore; 52 masa institucionale);
2. Antikorrupsion: 8 fusha tematike; 95 masa (38 nisma ligjore; 57 masa institucionale);
3. Sundimi i ligjit: 23 fusha tematike; 82 masa (17 nisma ligjore; 65 masa institucionale).

Dokumenti është konsultuar me të gjithë aktorët institucionalë dhe me kryenegociatoren për të bërë vlerësimin e përputhshmërisë së këtij dokumenti me angazhimet konkrete të shtetit shqiptar në kuadër të negociatave si dhe rekomandimeve të dhëna nga BE-ja gjatë procesit të negociatave. Për këtë dokument janë mbledhur dhe analizuar 160 komente të aktorëve të ndryshëm, përfshirë edhe grupin negociator. Plani Kombëtar i Veprimit për tri fushat gjendet i publikuar në faqen e komisionit www.masl.al

Çfarë pritet të ndodhë gjatë muajit korrik me agjendën e Komisionit të Posaçëm?

Gjatë muajit korrik pas miratimit të Planit Kombëtar të Veprimit do të nisë faza e tretë e procesit, që përfshin hartimin e projektligjeve për zbatimin konkret të masave të përcaktuara në dokument. Në kuadër të masave antikorrupsion, Komisioni i Posaçëm do të ngrejë dy grupe pune për hartimin e dy projektligjeve të rëndësishme: projektligjit “Për konfliktin e interesit” dhe projektligjit “Për financimin e partive politike”. Këto projektligje do të hartohen nga grupe pune të ekspertëve të GENL-së dhe Sekretariatit Teknik, stafit të Kuvendit dhe ekspertë të angazhuar nga institucione të pavarura, si ILDKPKI-ja dhe KQZ-ja. Ky proces do të mbështetet edhe me asistencën e ekspertëve të Këshillit të Europës.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar



KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

**“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN PËR
SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**